

## E drejta e Autorit. Miratohen tarifat e shpërblimit

2017-08-08 14:13:00



Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit në mbledhjen e tij të fundit, miratoi metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv. Për herë të parë, Shqipëria tashmë renditet mes vendeve europiane që adaptojnë një sistem transparent dhe që e aplikojnë këtë sistem tarifor në mënyrë të drejtë dhe të standartizuar me praktikën ndërkombëtare.

Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit në mbledhjen e tij të fundit, miratoi metodologjinë dhe masën e tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv. Për herë të parë, Shqipëria tashmë renditet mes vendeve europiane që adaptojnë një sistem transparent dhe që e aplikojnë këtë sistem tarifor në mënyrë të drejtë dhe të standartizuar me praktikën ndërkombëtare.

Ky sistem i miratuar tashmë i shërben së pari shpërblimit të drejtë dhe të merituar të autorëve, interpretuesve/ekzekutuesve dhe prodhuesve të fonogramit në vendin tonë dhe jashtë saj, por gjithashtu dhe klimës së biznesit dhe të drejtës së tyre legjitime për të paguar mbi produktin intelektual që përdorin, në mënyrë të ndershme.

Ky vendim miratohet në zbatim të reformës në fushën e të drejtës së autorit të ndërmarrë nga Ministria e Kulturës vitet e fundit. Administrimi kolektiv i të drejtave të krijuesve ka gjeneruar prej shumë e shumë vitesh problematika dhe konflikte të panumërta mes biznesit, subjekteve përdorues të produktit artistik dhe komunitetit të krijuesve. Procesi i miratimit të kësaj metodologjie, gjatë gjithë procesit të hartimit të saj është konsultuar me të gjitha grupet e interesit, ekspertet e WIPO-s dhe aktorëve ndërkombëtarë të industrive krijuese duke dhënë secili kontributin e tij të vlefshëm në interesin më të mirë të të gjithë palëve të interesuara. Reforma e nisur në fushën e të drejtës së autorit ka nisur me miratimin e kuadrit të ri ligjor, akteteve nënligjore rregulluese të zbatimit të tij, Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale 2016-2020, konstituimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), Vendimi i masës së tarifave etj. Të gjitha këto hapa në jetësimin e reformës së plotë në të drejtën e autorit tashmë janë një realitet që do të sjellë frytet e veta në rregullimin e tregut intelektual, normalizimit të raporteve tejet konfliktuale mes krijuesve dhe biznesit si dhe përmbushjen e detyrimeve që i lindin palës shqiptare gjatë procesit të integritimit europian në kuadër të Marrëveshjes së Asociim-Stabilizimit. Tarifat janë transparente, konkurruese për subjektet, jo arbitrare, çka ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në formalizimin e tregut duke siguruar në këtë mënyrë konkurrencë të lirë dhe duke i dhënë fund abuzimeve dhe problematikave të mbartura ndër vite, si rezultat i abuzimit me këto tarifa, por dhe duke nxitur subjektet e ndryshme përdorues për të paguar në mënyrë të rregullt AAK-të. Në këtë mënyrë sistemi funksionon në mënyrë të drejtë, subjektet përdorues paguajnë atë sa përdorin, artistët shpërblehen për kontributin e tyre. Procesi i hartimit të metodologjisë së tarifave u është referuar praktikave më të mira ekzistuese në Europë duke i vendosur ato me kuadrin e aplikueshëm ligjor, rrethanat ekonomike dhe kulturore

të vendit tonë dhe qëllimi i saj është të përmirësojë situatën e pagueshmërisë, të rritë bazën kontributore, dhe përdorueshmërisë së tarifave të mbledhura nga AAK-të përmes aplikimit të tarifave bilaterisht të pranuar dhe lehtësisht të aplikueshme / të zbatueshme, duke i dhënë fund abuzimeve dhe gangrenës së krijuar ndër vite tek subjektet përdorues.

Prioritet i kësaj metodologjie ka qenë që këto tarifa të miratura të ishin të thjeshta, të kuptueshme dhe të zbatueshme nga të gjithë subjektet përdorues të pronësisë artistike. Metodologjia shmang mundësinë e paligjshme që Agjencitë e Administrimit Kolektiv të abuzojnë me fuqinë e tyre të tregut, duke vendosur çmime të paarsyeshme ose të angazhohen në praktika diskriminuese, të tilla si aplikimi i tarifave të ndryshme për përdoruesit e ngjashëm që veprojnë në të njëjtat tregje. Aplikimi i deritanishëm ka qënë tejet i kontestuar nga subjektet dhe praktikisht i pa aplikueshëm. Si rezultat i kësaj është trashëguar një realitet abuzues, viktimizues për të gjitha palët në këtë proces. Tashmë me këtë sistem tarifor vendoset ekuilibri i munguar mes palëve duke i dhënë fund abuzimeve në tregun e produktit artistik. Më poshtë shkarkoni vendimin e miratuar të KKDA-së:

<http://www.kultura.gov.al/al/baza-ligjore/e-drejta-e-autorit>